

STATISTIKAT E PESHKIMIT

2026

Në vitin 2025, sasia e peshkut të zënë nga të gjitha kategoritë ujore ishte 15.153 tonë, duke shënuar një rënie prej 7,9 %, krahasuar me një vit më parë që ishte 16.452 tonë. Gjatë vitit 2025, u prodhuan dhe u hodhën në liqenin e Ohrit 1,2 milionë rasate të Troftës Ylber, 2 milionë rasate të Koranit dhe 0,6 milionë rasate Krap.

Struktura e zënieve nga peshkimi sipas kategorive

- Akuakultura përbën 43,2 % (6.549 tonë)
- Ujërat e brendshme zënë 19,8 % (3.007 tonë)
- Peshkimi detar përfaqëson 29,2 % (4.426 tonë)

Ndryshimet vjetore të zënieve sipas kategorive ujore

- Molusqe: rritja më e madhe me +158,2 %, (nga 213 tonë në vitin 2024 në 550 tonë në 2025)
- Laguna: rënie me -8,2 %, (nga 146 tonë në vitin 2024 në 134 tonë në 2025)
- Akuakulturë: rënie me -8,6 %, (nga 7.165 tonë në vitin 2024 në 6.549 tonë në 2025)
- Bregdet: rënie me -12,1 %, (nga 554 tonë në vitin 2024 në 487 tonë në 2025)

Zëni sipas specieve kryesore

Në det, bregdet dhe lagunë:

- Karkaleci i thellësisë: 15,9 % (802 tonë)
- Merluc: 13,7 % (693 tonë)
- Sardele: 15,2 % (765 tonë)

Në ujërat e brendshme:

- Karas: 33,9 % (1.018 tonë)
- Skortë: 23,6 % (709 tonë)
- Krap: 18,2 % (546 tonë)

Flota detare

Në vitin 2025 janë të licencuara 854 subjekte për aktivitet peshkimi, 21 subjekte më shumë se në vitin 2024. Flota operon kryesisht në Nën-Zonën Gjeografike 18 (Adriatiku i Jugut).

Sipas porteve:

- Durrës: 36,3 % e anijeve të licencuara
- Vlorë: 30,6 %
- Lushnje-Fier: 2,1 %
- Himarë: 1,6 %

Sipas llojit të anijeve:

- Anije me njica: 73,2 %
- Anije me tërheqje (fundore/pelagjike): 23,5 %

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Statistikat e Peshkimit](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Statistikat e Peshkimit](#)

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Statistikat e peshkimit për vitin 2025 mbështeten në informacionin administrativ të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i tyre mbështeten në legjislacionin vendas, si dhe në zbatimin e klasifikimeve dhe përkufizimeve sipas rregulloreve përkatëse të BE-së:

- Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare";
- Ligj Nr. 30/2022 "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026";
- Regullorja (EC) Nr. 218/2009 mbi "Statistikat e Zënieve të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut";
- Regullorja (EC) Nr. 762/2008 mbi "Statistikat e Akuakulturës".

Informacioni statistikor lidhur me peshkimin dhe akuakulturën grumbullohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke u mbështetur në metodikën e GFCM (General Fisheries Commission for the Mediterranean) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës, etj. Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore dhe në nivel vendi.

Variablat kryesore grupohen në këto kategori:

- Zënie peshku sipas kategorive ujore:
 - a) Detar;
 - b) Bregdet;
 - c) Laguna;
 - d) Ujëra të brendshme;
 - e) Akuakultura;
 - f) Molusqe.
- Zënie sipas specieve kryesore:
 - a) Açuga;
 - b) Karkalec i thellësisë;
 - c) Merluc;
 - d) Sardele;
 - e) Etj.
- Flota detare sipas porteve të peshkimit:
 - a) Durrës;

- b) Vlorë;
 - c) Saranda;
 - d) Shëngjin;
 - e) Himara;
 - f) Lushnje –Fier.
- Flota Detare sipas llojt të anijes:
 - a) Me tërheqje (fundore dhe pelagjike);
 - b) Me mrezha;
 - c) Me koshilok;
 - d) Me draga hidraulike;
 - e) Me njica;
 - f) Anije shumëpërdorimshe.

Përkufizime:

Peshkimi

Të dhënat zënie peshku (prodhim peshku dhe akuakultura) grumbullohen sipas kategorive ujore.

Kategoritë ujore të peshkimit janë: peshkimi detar, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe.

Peshkimi detar: Përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës së peshkimit dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Kapaciteti i peshkimit

Është sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi.

Zënie peshku

Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

Akuakultura

Është rritja e peshkut në kushte artificiale, në të cilin përfshihen: rritje peshku me anë të rasateve, molusqe dhe krustance

Flota

Është numri total i anijeve të peshkimit që shfrytëzon një burim të caktuar. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut).

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijes ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi:

Me tërheqje (fundore dhe pelagjike) – Metoda e peshkimit me tërheqje është një nga metodat më të rëndësishme dhe më efikase të peshkimit në botë. Kjo metodë përdoret si në ujëra të cekëta, ashtu edhe në thellësi deri në 2 000 metra. Rrjetat tërheqëse përdoren për peshkim fundor dhe pelagjik, në varësi të formës së rrjetës së përdorur. Procesi i tërheqjes kryhet për një periudhë dhe në një distancë të caktuar, deri në ngritjen e rrjetës dhe zbrazjen e saj. Ky mjet peshkimi përdoret kryesisht për kapjen e peshqve fundorë.+

Me mrezha – Këto anije përdorin rrjeta rrethuese dhe detare dhe përbëjnë një grup të madh mjetesh me madhësi të ndryshme, duke filluar nga anije të hapura, zakonisht me gjatësi të paktën 10 metra, deri te anijet që operojnë në oqean. Këto mjete përdoren zakonisht për kapjen e specieve pelagjike që grumbullohen në tufa.

Me koshilok – Përbëjnë një grup anijesh që përfshin mjete të të gjitha madhësive, duke filluar nga varka të vogla deri te anijet që peshkojnë në oqean. Koshilokët janë mjetet më të rëndësishme dhe më efektive për kapjen e specieve që grumbullohen pranë sipërfaqes së ujit. Mjeti rrethon tufën me anë të rrjetës, ndërsa më pas pjesa e poshtme e saj mbyllet (nën tufë) me anë të një litari, i cili nisët nga anija, kalon nëpër unazat e vendosura në fund të rrjetës dhe kthehet përsëri në anije.

Dragat janë mjete peshkimi që gërryejnë fundin e detit për kapjen e molusqeve bivalvë. Ato përbëhen nga një konstruksion metalik, në të cilin fiksohet një thes i ndërtuar me unaza metalike ose me rrjetë. Dragat mund të tërhiqen nga anije ose me anë të krahëve mekanikë. Këto mjete përdoren kryesisht në zonat bregdetare dhe peshkojnë duke qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me tabanin detar.

Me njica – Madhësia e anijeve ndryshon në varësi të zonës së peshkimit. Këto mjete mund të jenë varka të vogla për ujërat e brendshme dhe bregdetare, anije të vogla me kuvertë për ujërat bregdetare, si dhe anije të mesme që peshkojnë në det të hapur. Në ujërat bregdetare është shumë e zakonshme që kjo formë peshkimi të përdoret si metodë dytësore, në varësi të sezonit të peshkimit dhe të specieve të synuara.

Anije shumëpërdorimshe – Mjete peshkimi që përdorin në mënyrë alternative dy ose më shumë vegla peshkimi, pa modifikime të mëdha në anije.